



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës – E Hapur - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përefekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI: “Blerje dhe furnizim me ushqim të ambalazhuar për qen (Junior dhe Adult), për nevojat e Strehës së Kafshëve ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: Kodi CPV: ,15713000-9 Ushqim kafshesh

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,163,600 (Dy milion e njëqind e gjashtedhjetë e tre mijë e gjashteqind) leke PA TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *"Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose te ofertave Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik"*.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP *"Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël"*.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:** Sipas shtojcës 9 të këtyre dokumenteve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të vlerës së fondit limit.Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/c e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Për sa i takon

përcaktimit të vlerës së kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur e fondit limit të kontratës është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;”

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për keste të maturuara të vitit 2026 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nëni 5, pika c.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 43 pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e vërtetimit të shlyerjes së taksave vendore është vendosur në funksion të verifikimit të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe fiskale nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Dokumentacioni i kërkuar i shërben Autoritetit Kontraktor për të garantuar që operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurë ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me legjislacionin fiskal dhe administrativ në fuqi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 30 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për furnizimin me artikujt objekt prokurimi. Në rast se autorizimi lëshohet nga një distributor i autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe dokumentacionin që provon marrëdhënien e autorizimit ndërmjet distributorit dhe prodhuesit.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë deklaratë mbi disponimin e kapaciteteve teknike dhe logjistike për furnizimin, transportin dhe dorëzimin e kafazeve sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit dhe nevojën për garantimin e realizimit me sukses të kontratës. Kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar prej tij përcaktohet me qëllim **verifikimin e origjinës dhe burimit të produkteve të ofruara**, si dhe garantimin e një zinxhiri të identifikueshëm furnizimi për ushqimin e kafshëve. Dokumentacioni që provon marrëdhënien e autorizimit ndërmjet distributorit dhe prodhuesit kërkohet për të mundësuar **verifikimin e vlefshmërisë së autorizimit** dhe për të shmangur paqartësitë lidhur me burimin dhe të drejtën e subjektit për të furnizuar produktet objekt të prokurimit. Kërkesa për përkthimin e dokumenteve të paraqitura në gjuhë të huaj në gjuhën shqipe synon të mundësojë **kuptimin dhe verifikimin e saktë të dokumentacionit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**, duke siguruar një vlerësim të barabartë dhe objektiv të dokumenteve të paraqitura. Kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synon të garantojë **gjurmueshmërinë, origjinën dhe besueshmërinë e produkteve të furnizuara**, pa përcaktuar një prodhues ose markë të veçantë.

2.3.3. Operatori ekonomik Për secilin produkt të ofruar, duhet të paraqesë:

a) Fletë teknike, katalog ose dokumentacion zyrtar të prodhuesit, ku të identifikohen qartë produkti, prodhuesi, kategoria sipas moshës, përbërja, parametrat ushqyes, kushtet e ruajtjes dhe afati i përdorimit, sipas rastit. Katalogu, fleta teknike ose dokumentacioni tjetër i paraqitur duhet të jetë **i markuar/evidentuar qartë për produktin e ofruar dhe për parametrat teknikë përkatës**, në mënyrë që të mundësohet verifikimi i përputhshmërisë së tij me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

b) Deklaratë të operatorit ekonomik, me anë të së cilës garanton se produktet e ofruara janë në ambalazhin origjinal të prodhuesit, të padëmtuar, me afat përdorimi të vlefshëm në momentin e furnizimit dhe të përshtatshme për kategorinë e moshës për të cilën ofrohen. Operatori ekonomik duhet të deklarojë gjithashtu se produktet do të transportohen dhe ruhen në përputhje me kushtet e përcaktuara nga prodhuesi.

c) Nga një mostër fizike për secilin produkt të ofruar, përkatësisht për ushqimin e qenve të moshës **6–12 muaj** dhe për ushqimin e qenve të moshës **mbi 12 muaj**. Mostrat duhet të jenë në ambalazhin origjinal të prodhuesit, të padëmtuar dhe të identifikueshëm, dhe do të përdoren për verifikimin e përputhshmërisë së produktit me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Dorëzimi i kampioneve/mostrave do të bëhet pranë Bashkisë Vlorë, në vendin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor dhe brenda afatit të përcaktuar në dokumentet e procedurës.

Mostrat duhet të jenë të paketuara, të mbyllura dhe të identifikuara qartë me etiketë, ku të shënohen të dhënat identifikuese të operatorit ekonomik dhe artikulli përkatës. Mbi paketimin e mostrave duhet të vendoset shënimi:

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE TË KËSAJ PROCEDURE PROKURIMI.”

Së bashku me mostrat, operatori ekonomik duhet të paraqesë një shkresë të firmosur dhe të vulosur, ku të jetë listuar në mënyrë të qartë numri dhe përshkrimi i mostrave të dorëzuara, duke përcaktuar lidhjen e secilës mostër me artikullin përkatës të listës së produkteve.

Dorëzimi i mostrave do të dokumentohet nga Autoriteti Kontraktor nëpërmjet procesverbalit përkatës.

Argumentimi Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Kërkesa për paraqitjen e **fletës teknike, katalogut ose dokumentacionit zyrtar të prodhuesit** për secilin produkt është përcaktuar me qëllim mundësimin e verifikimit

objektiv të karakteristikave dhe parametrave teknikë të ushqimit të ofruar, si dhe të përputhshmërisë së tij me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Identifikimi i produktit, prodhuesit, kategorisë së moshës, përbërjes dhe parametrave ushqyes është i nevojshëm për të garantuar që produkti i ofruar është i përshtatshëm për kategorinë e qenve për të cilën kërkohet..

Kërkesa që dokumentacioni teknik të jetë i markuar/evidentuar qartë për produktin dhe parametrat përkatës synon të lehtësojë procesin e verifikimit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe të shmangë paqartësitë gjatë krahasimit të produktit të ofertuar me kërkesat teknike të DST-së. Kjo mundëson një vlerësim të qartë, transparent dhe të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Kërkesa për paraqitjen e **deklaratës së operatorit ekonomik** synon të sigurojë angazhimin e tij për furnizimin e produkteve në ambalazhin origjinal të prodhuesit, të padëmtuar, me afat përdorimi të vlefshëm dhe në përputhje me kategorinë e moshës së përcaktuar, si dhe garanton respektimin e kushteve të ruajtjes dhe transportit të përcaktuara nga prodhuesi.

Kërkesa për paraqitjen e **mostrave fizike** është e nevojshme për të mundësuar verifikimin praktik të përputhshmërisë së produkteve të ofruara me specifikimet teknike, përfshirë identifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe karakteristikat e deklaruara në dokumentacionin teknik. Paraqitja e nga një mostre për secilën kategori produkti, përkatësisht për qentë **6–12 muaj dhe mbi 12 muaj**, mundëson kontrollin konkret të produkteve që operatori ekonomik propozon të furnizojë.

Kërkesat për **paketimin, identifikimin dhe listimin e mostrave**, si dhe dokumentimin e dorëzimit të tyre nëpërmjet procesverbalit, synojnë të garantojnë **gjurmueshmërinë**, integritetin dhe administrimin e rregullt të mostrave gjatë procesit të vlerësimit. Në tërësi, këto kërkesa janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synojnë të garantojnë **cilësinë, sigurinë, përshtatshmërinë për kategorinë e përcaktuar të qenve dhe përputhshmërinë e produkteve me kërkesat teknike**, duke krijuar një bazë të qartë dhe objektive për vlerësimin e ofertave.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistët e fushës, te paraqitur ne shtojcen 6 te DST.*

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon

produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

ARGUMENTIM TEKNIK PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet teknike për furnizimin me ushqim të thatë për qen janë përcaktuar në funksion të nevojave ushqyese të kafshëve që do të trajtohen dhe mbahen në strehë, duke marrë në konsideratë fazën e moshës, nevojat për energji dhe lëndë ushqyese, si dhe kërkesat për ruajtjen dhe sigurinë e produktit gjatë gjithë periudhës së furnizimit.

Ndarja e ushqimit në dy kategori, **Junior (6–12 muaj)** dhe **Adult (mbi 12 muaj)**, është përcaktuar për shkak të ndryshimit të nevojave ushqyese ndërmjet qenve në fazën e rritjes dhe qenve të rritur. Ushqimi për qentë Junior duhet të jetë i përshtatshëm për fazën e rritjes dhe zhvillimit, ndërsa ushqimi për qentë Adult duhet të jetë i përshtatshëm për mirëmbajtjen dhe ushqimin e përditshëm të qenve të rritur.

Kërkesat për **minimumin e proteinës dhe yndyrës** janë përcaktuar për të garantuar një furnizim të përshtatshëm me lëndë ushqyese dhe energji. Për kategorinë Junior kërkohet një nivel më i lartë proteinash dhe yndyre, në përputhje me nevojat më të larta ushqyese të kafshëve gjatë fazës së rritjes.

Kufijtë maksimalë të përcaktuar për **fibrën, hirin dhe lagështinë** synojnë të sigurojnë që produkti të ketë një përbërje të përshtatshme për ushqim të thatë dhe të ruajë karakteristikat e tij gjatë magazinimit dhe përdorimit.

Kërkesa për përmbajtjen e **vitaminave dhe mineraleve esenciale**, si dhe veçanërisht për **kalciumin dhe fosforin**, lidhet me nevojën për sigurimin e një ushqimi të plotë dhe të balancuar. Kalciumi dhe fosfori janë veçanërisht të rëndësishëm për qentë në fazën e rritjes, për mbështetjen e zhvillimit normal të skeletit.

Përcaktimi i **paketimit 20 kg/thes, me tolerancë $\pm 5\%$** , është bërë në funksion të nevojave të furnizimit, magazinimit dhe shpërndarjes së ushqimit, duke mundësuar administrim më të përshtatshëm të sasive të furnizuara.

Kërkesa që produkti të dorëzohet në **ambalazh origjinal, të mbyllur dhe të padëmtuar**, si dhe të ketë të deklaruara në etiketë përbërjen, analizën ushqyese, peshën neto, datën e prodhimit, afatin e përdorimit dhe informacionin për përdorimin dhe ruajtjen, synon të garantojë identifikimin, gjurmueshmërinë dhe kontrollin e produktit në momentin e furnizimit.

Përcaktimi i një **afati të mbetur përdorimi prej të paktën 12 muajsh në momentin e dorëzimit** synon të sigurojë që produkti të jetë i përshtatshëm për përdorim gjatë periudhës së magazinimit dhe shpërndarjes dhe të shmangë furnizimin me produkte pranë skadencës.

Kërkesa që produkti të jetë i prodhuar dhe i tregtueshëm në përputhje me **legjislacionin në fuqi për ushqimin e kafshëve dhe kërkesat e sigurisë ushqimore** synon të garantojë sigurinë, cilësinë dhe përshtatshmërinë e produktit për konsum nga kafshët.

Gjithashtu, kërkesa që gjatë gjithë periudhës së kontratës produktet e furnizuara të **përmbushin të njëjtat specifikime teknike dhe parametra ushqyes të deklaruar dhe të pranuar**, garanton vazhdimësinë e cilësisë së furnizimit dhe siguron që ndryshimi i sasive të furnizuara gjatë ekzekutimit të kontratës të mos shoqërohet me ndryshim të karakteristikave teknike dhe ushqyese të produktit.

Në përfundim, specifikimet teknike janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të sigurojnë **përshtatshmërinë ushqyese, sigurinë, cilësinë, gjurmueshmërinë dhe ruajtjen e produktit**, duke i dhënë Autoritetit Kontraktor mundësinë për të verifikuar objektivisht përputhshmërinë e produkteve të ofruara me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

NJËSIA E PROKURIMIT